



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.382/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “I...P...” SH.P.K., me seli në Kaçanik, kundër debitorit “A...” me seli në Kaçanik, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, PPP.nr.136/2018 të datës 13.02.2020, me datë 31.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit A...” SH.P.K., me seli në Ferizaj, Rr.“...”, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, PPP.nr.136/2018 i datës 13.02.2020 dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Komerciale – Dhomës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.136/2018 të datës 13.02.2020, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar prapësimin e debitorit “A...” me seli në Kaçanik, të ushtruar me 23.12.2019, kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat P.nr.304/2019 të datës 18.12.2019, në tërësi si të pabazuar. Në pikën II të dispozitivit ka urdhëruar debitorin “A...” me seli në Kaçanik, që në emër të garancionit në të holla në rast ankese të paguaj shumën prej 20.287.00 Euro, e nëse garancioni nuk paguhet konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare, garancioni duhet të paguhet në llogarinë me numër-BQK. Në pikën III të dispozitivit ka detyruar debitorin që të bëjë ekzekutimin e urdhrin P.nr.304/2019 si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto pagesa brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (pretendime të kuptuara nga referati i ankesës), me propozim që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar PPP.nr.136/2018 i datës 13.02.2020, ashtu që ta anuloj urdhrin përmbarimor P.nr.304/2019 i datës 18.12.2019.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “I...P...” SH.P.K., me seli në Kaçanik, me datë 18.12.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit “A...” me seli në Kaçanik, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr.0103/15-D të datës 01.03.2015, faturës nr.0505/15-D të datës 05.05.2015, faturës nr.0206/15-D të datës 02.06.2015 dhe faturës nr.2506/15-D të datës 25.06.2015, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 20,287.44 Euro.

Përmbartuesi privat Sheremet H. Livoreka, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.304/2019 të datës 18.12.2019, ka lejuar përmbartimin, duke vlerësuar se faturat e lëshuar nga kreditori i plotësojnë kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim me datë 23.12.2019, duke e kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me propozim që i njëjti të anulohet dhe të aprovohet prapësim, me arsyetimin se debitori asnjëherë nuk i ka pranuar këto fatura, i njëjti ka paguar në tërësi detyrimin ndaj kreditorit dhe se ky detyrim po të ekzistonte si i tillë është parashkruar. Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori me datë 24.12.2019, me propozim që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar në prova dhe në ligj.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, pas shqyrtimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.136/2018 të datës 13.02.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit për shkak se i njëjti nuk është mbështetur në prova, ashtu siç është paraparë me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, e po ashtu nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parapara me nenin 71 paragrafi 1 të LPP-së. Tutje ka arsyetuar se faturat në bazë të së cilave është paraqitur propozimi për përmbartim janë titull ekzekutiv dhe i kanë të gjitha tiparet e përmbartueshmërisë sipas nenit 29 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 3 të LPP-së dhe se të njëjta i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt debitori, fakt ky i vërtetuar nga nënshkrimi në fletëdërgesat, të cilat janë nënshkruar nga debitori.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, nuk e përkrah Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishtë të shkresave të lëndës, si dhe ankesën e palës ankuese ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale për të cilën gjykata çdoherë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së

parë. Po ashtu kjo gjykatë ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK-së si dhe lidhur me nenin 17 dhe 38 të LPP-ës, për çka u deshtë që ky aktvendim të anulohet dhe çështja t'i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomës së shkallës së parë në rivendosje.

Kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë kur ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe e ka lejuar urdhrin përmbarrimor, pasi që dokumenti i besueshme – fatura nr.0103/15-D e datës 01.03.2015, fatura nr.0505/15-D e datës 05.05.2015, fatura nr.0206/15-D e datës 02.06.2015 dhe fatura nr.2506/15-D e datës 25.06.2015, në bazë të së cilave është lejuar përmbarrimi nuk janë të përshtatshme për përmbarrim, përkatësisht të njëjtat nuk i plotësojnë kushtet ligjore të parapara me LPP për të qenë dokumente të besueshme. Kjo pasi që në rastin konkret kreditori ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave, të cilat fatura nuk janë të nënshkruar nga debitori, si dhe nuk ka prova se të njëjtat i janë dorëzuar debitorit, andaj në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parapara me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.1. të LPP, ku në qarkullimin afarist fatura duhet të jetë kthyese, që nënkupton se debitori duhet t'i pranoj të njëjtat, për tu plotësuar kushti si dokument i besueshëm. Në lidhje me këtë, në shkresa të lëndës gjenden edhe fletë dërgesat për pranimin e mallit, në bazë të së cilave pretendohet se debitori ka pranuar faturat, mirëpo në këto fletë dërgesa është shënuar vetëm data, emërtimi i mallit, njësia matëse dhe sasia, kurse numri i faturës dhe vlera e mallit (shuma) nuk është shënuar, që nënkupton se nuk mund të vërtetohet se këto fletë dërgesa a janë për faturat në fjalë, pasi që në të njëjtat nuk është numri i faturës dhe çmimi, në mënyrë që të nënkuptohej se brenda këtyre dërgesave për pranim gjenden faturat si dokument përmbarrimor. Andaj, në këtë drejtim Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk e përkrah qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me përshtatshmërinë e përmbarrueshmërisë së dokumentit përmbarrimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, për çka edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk ka pengesa që lidhur më evitimin e paqartësive në këtë lëndë përmbarrimore, në kuptim të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së parë eventualisht të caktoj seancë publike në të cilën të ftoj palët në procedurë dhe pastaj përmes dëgjimit dhe deklarimit të tyre, por edhe përmes pyetjeve të cilat do të mund tu parashtroheshin nga gjykata, ajo do të kishte mundësi objektive dhe reale që t'i eliminonte paqartësitë, duke mos përjashtuar edhe hetimin e ndonjë rrethane tjetër e cila do të ishte në interes të gjykatës për të vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe të merrte një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, pa përjashtuar edhe aspektin e udhëzimit të palës përkatëse në kuptim të veprimeve procedurale të cilat ajo palë mund apo duhet t'i kryej për sqarimin dhe plotësimin e dokumentit përkatës përmbarrimor në mënyrë që procedura në këtë çështje përmbarrimore të përfundoj me nxjerrjen e një vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Andaj në ri procedurë, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së parë udhëzohet që t'i ketë parasysh shkeljet e cekura si më lartë dhe që për evitimin e tyre lidhur çështjen në fjalë, të ndërmerr veprime përkatëse të nevojshme përmes të cilave së pari duke respektuar dispozitat e LPP, mbi përshtatshmërinë e dokumentit në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi, e pastaj duke respektuar dispozitat e LPP dhe LPK të të merr një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Për këto arsye kjo gjykatë gjeti se aktvendimi i ankimuar duhet prishur dhe çështja duhet kthyer në rivendosje tek Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur kushte që të i njëjti aktvendim të mund të ndryshohet nga ana e Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të nenit 208 dhe 209 pika (d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.382/2022, me datë 31.08.2022

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti